

**GRATË AFARISTE NË KOSOVË**

**ŽENE PREDUZETNICI NA KOSOVU**

**WOMEN ENTREPRENEURS IN KOSOVO**

Pikëpamjet dhe analizat e përfshira në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk paraqesin pikëpamjet e UNMIK-ut. Nuk ka të drejta të fotokopjimit të bashkangjitura në këtë publikim. Mund të riprodhohet në tërësi ose pjesërisht me kusht që të përmendet burimi.

Mišljenja i analiza na ovu publikaciju su autorova i ne predstavljaju mišljenje UNMIK-a. Ne postoje fotokopirana prava privezana sa ovom publikacijom. Može biti umnožena u celini ili u delovima pod uslovom da se prizna izvor.

The views and analyses contained in this publication are those of the authors and do not necessarily represent the views of UNMIK. There is no copyright attached to this publication. It may be reproduced in whole or in part providing the source is acknowledged.

UNMIK Office of Gender Affairs  
MHQ, East Wing, 5<sup>th</sup> Floor  
Prishtinë/Pristina (Kosovo)  
Tel. +381.38.504.604 ext. 5741  
Fax +381.38.504.604 ext. 5826  
<http://officeofgenderaffairs.unmikonline.org>

Women's Business Association SHE-ERA  
Address: "Tirana" St. No/No (Tranzit)  
Gjakovë/Djakovica (Kosovo)  
Tele/Fax: +381 390 23 194  
E-mail: [wsheera@gmail.com](mailto:wsheera@gmail.com)  
[www.she-era.org](http://www.she-era.org)

**Menaxheret e projektit/ Menadžeri projekata /Project Managers/** Mirlinda Kusari and Maddalena Pezzotti

**Drejtoresh për Hulumtim/Direktor za Istrazivanje/Research Director/** Mirlinda Kusari

**Analiza dhe përpunimi i të dhënave/Obrada podataka/Data analysis and processing/** Mirlinda Kusari and Albina Nura

**Përpunimi gjuhësor/ Uredivanje jezika/ Language editing/** John Cliffor and UNMIK / Office of Gender Affairs

**Përkthimi /Prevod /Translation/**Krenare Kurtishi and UNMIK Language Unit

**Dizajnimi i ballinës/ Dizajn korica/Cover Design/** Studio Design "SUART" Gjakovë/Djakovica

**Faqosja e librit/Izgled knjige /Book layout /** Studio Design "TWINS" Prishtinë/Priština

**Shtypja/Štampanje/Printing/** Studio Design "TWINS" Prishtinë/Priština

## **Mirënjohje**

Shoqata e Grave Affariste "SHE-ERA" dhe UNMIK Zyra për Çështje Gjinore dëshiron të falenderojë për bashkëpunim të çmuar dhe kontributin e dhënë në mbledhjen e të dhënave: Adelina Nallbani, Gjakovë/Djakovica; Albina Dobruna, Prishtinë/Priština; Anica Milković, Shtërpce/ Šterpce; Arbenita Llapashtica, Novobërd/Novo Berdo; Arta Mazrekaj, Deqan/Decane; Azra Haxhijaha, Rahovec/Orahovac; Blerina Binaku, Kacanik/Kacanik; Bukurije Gashi, Mitrovicë/Mitrovica; Donika Dubaovci, Drenas/Glogovac; Gjenisere Muqaj, Suharekë/Suva Reka; Igballe Hakiqi,

Podujevë/Podujevo; Ilirjana Sadikaj, Istog/Istok; Labërije Qeriqi, Shtime/Stimlje; Lale Grabanica, Klinë/Klina; Luljeta Kryeziu, Dragash/Dragas; Melihate Osmani, Viti/Vitina; Mihrije Bytyqi, Malishevë/Malisevo; Mimoza Bibaj, Prizren/Prizren; Nezahate Dervisholli, Fushë Kosovë/Kosovo Polje; Njomza Dubovci, Obiliq/Obilic; Nora Haziri, Gjilan/Gnjilane; Olivera Milošević, Zubin Potok/Zubin Potok; Radmila Đorđević, Leposavić/Leposavic; Sanije Jahiri, Kamenicë/Kamenica; Shehindere Dedushi, Lipjanë/Lipljan; Slađana Radović, Zvečan/Zvecan; Valentina Bibaj, Pejë/Pec; Valimira Delia, Skenderaj/Serbica; Vjollca Hajra, Vushtrri/Vucitrn; Zejnepe Reqica, Ferizaj/Urosevac.

### **Zahvalnica**

Poslovna Asocijacija Zena “SHE-ERA” i UNMIK-ova Kancelarija za Pitanja Polova zeli da se zahvali na dragocenoj saradnji i doprinosu u prikupljanju podataka: Adelina Nallbani, Gjakovë/Djakovica; Albina Dobruna, Prishtinë/Pristina; Anica Milković, Shtërpce/Sterpce; Arbenita Llapashtica, Novobërd/Novo Berdo; Arta Mazrekaj, Deqan/Decane; Azra Haxhijaha, Rahovec/Orahovac; Blerina Binaku, Kacanik/Kacanik; Bukurije Gashi, Mitrovicë/Mitrovica; Donika Dubaovci, Drenas/Glogovac; Gjenisere Muqaj, Suharekë/Suva Reka; Igballe Hakiqi, Podujevë/Podujevo; Ilirjana Sadikaj, Istog/Istok; Labërije Qeriqi, Shtime/Stimlje; Lale Grabanica, Klinë/Klina; Luljeta Kryeziu, Dragash/Dragas; Melihate Osmani, Viti/Vitina; Mihrije Bytyqi, Malishevë/Malisevo; Mimoza Bibaj, Prizren/Prizren; Nezahate Dervisholli, Fushë Kosovë/Kosovo Polje; Njomza Dubovci, Obiliq/Obilic; Nora Haziri, Gjilan/Gnjilane; Olivera Milošević, Zubin Potok/Zubin Potok; Radmila Đorđević, Leposavić/Leposavic; Sanije Jahiri, Kamenicë/Kamenica; Shehindere Dedushi, Lipjanë/Lipljan; Slađana Radović, Zvečan/Zvecan; Valentina Bibaj, Pejë/Pec; Valimira Delia, Skenderaj/Serbica; Vjollca Hajra, Vushtrri/Vucitrn; Zejnepe Reqica, Ferizaj/Urosevac.

### **Acknowledgments**

The Women’s Business Asociation “SHE-ERA” and UNMIK Office of Gender Affairs would like to thank for the precious collaboration and contribution in collection of data: Adelina Nallbani, Gjakovë/Djakovica; Albina Dobruna, Prishtinë/Pristina; Anica Milković, Shtërpce/Sterpce; Arbenita Llapashtica, Novobërd/Novo Berdo; Arta Mazrekaj, Deqan/Decane; Azra Haxhijaha, Rahovec/Orahovac; Blerina Binaku, Kacanik/Kacanik; Bukurije Gashi, Mitrovicë/Mitrovica; Donika Dubaovci, Drenas/Glogovac; Gjenisere Muqaj, Suharekë/Suva Reka; Igballe Hakiqi, Podujevë/Podujevo; Ilirjana Sadikaj, Istog/Istok; Labërije Qeriqi, Shtime/Stimlje; Lale Grabanica, Klinë/Klina; Luljeta Kryeziu, Dragash/Dragas; Melihate Osmani, Viti/Vitina; Mihrije Bytyqi, Malishevë/Malisevo; Mimoza Bibaj, Prizren/Prizren; Nezahate Dervisholli, Fushë Kosovë/Kosovo Polje; Njomza Dubovci, Obiliq/Obilic; Nora Haziri, Gjilan/Gnjilane; Olivera Milošević, Zubin Potok/Zubin Potok; Radmila Đorđević, Leposavić/Leposavic; Sanije Jahiri, Kamenicë/Kamenica; Shehindere Dedushi, Lipjanë/Lipljan; Slađana Radović, Zvečan/Zvecan; Valentina Bibaj, Pejë/Pec; Valimira Delia, Skenderaj/Serbica; Vjollca Hajra, Vushtrri/Vucitrn; Zejnepe Reqica, Ferizaj/Urosevac.

# **GRATË AFARISTE NË KOSOVË**

## **Shqyrtimi i bizneseve në pronësi të grave për vitin 2006**

### **PËRMBAJTJA**

<b>Parathënje.....</b>	.....
<b>Gratë në ekonomi në Kosovë.....</b>	.....
<b>Kapitulli 1. Llojet e veprimatis afariste.....</b>	.....
<b>Kapitulli 2. Numri i të punësuarve.....</b>	.....
<b>Kapitulli 3. Kohëzgjatjka e veprimtaris afariste.....</b>	.....
<b>Kapitulli 4. Lokacioni i veprimtaris afarist .....</b>	.....
<b>Kapitulli 5. Vendndodhja e konsumatorëve .....</b>	.....
<b>Kapitulli 6. Distanca e shërbimeve afariste .....</b>	.....
<b>Kapitulli 7. Koha e cila i përkushtohet veprimtaris afariste .....</b>	.....

<b>Kapitulli 8. Motivimi për të filluar veprimtarin afariste</b> .....
<b>Kapitulli 9. Qëllimi kryesor i veprimtaris afariste</b> .....
<b>Kapitulli 10. Përgjegjësia vendim marrëse</b> .....
<b>Kapitulli 11. Ndërthurja e familjes dhe veprimtaris afariste</b> .....
<b>Kapitulli 12. Pengesat dhe vështirësit</b> .....
<b>Kapitulli 13. Këshillat afariste</b> .....
<b>Kapitulli 14. Ardhmëria e veprimtaris afariste</b> .....
<b>Kapitulli 15. Trainimi dhe zhvillimi</b> .....
<b>Kapitulli 16. Studime rasti të grave të suksesshme afariste të Kosovës</b> .....
<b>Kapitulli 17. Konkludime</b> .....
<b>Kapitulli 18. Rekomandime</b> .....
<b>Akronimet dhe shkurtesat</b> .....

## **Parathënje**

Mungesa e të dhënave analitike lidhur me pronësinë e afarizmit të grave në Kosovë ishte bazë e këtij projekti. Analiza e karakteristikave të biznesit të grave është thelbësore jo vetëm për shkaqe empirike, por edhe për të arsimuar dhe mbështetur qëndrueshmërinë ekonomike në Kosovë. Gratë shpeshherë veprojnë me një kapacitet jo zyrtarë dhe të paregjistruar. Mungesa e informatës cilësore dhe sasiore për rolin e tyre në ekonomi vështirëson zgjerimin e potencialit të kësaj vlere të paprekur të kapitalit njerëzor.

Gjatë këtij hulumtimi, u identifikuan fytet e ngushta dhe mundësitë në sektorin formal dhe jo formal të afarizmit të cilët janë në pronësi, ose udhëhiqen nga gratë. Prandaj, konkluzionet dhe rekomandimet do t'ju sigurojnë institucioneve qeveritare, donatorëve dhe investitorëve të huaj një plan të politikës së ardhshme zhvillimore në strategjinë ekonomike.

Projekti ka për qëllim një varg objektivash për të kontribuar në implementimin e Platformës për Veprim të Konferencës së Katërt Botërore, të mbajtur në Pekin të Kinës në vitin 1995, dhe përpjekjet e promovuar vendore për të avancuar agjendën e barazisë gjinore. Posaçërisht:

1. të sigurojë informatat e fundit për llojin, strukturën dhe madhësinë e veprimtarive afariste të cilat aktualisht udhëhiqen nga gratë në Kosovë;
2. të identifikojë problemet kyçe dhe pengesat financiare në procesin e zhvillimit të afarizmit;
3. të bëjë të dukshme iniciativat e grave dhe sukseset e tyre;

4. të propozojë masat për të stimuluar aktivitetet e afarizmit të udhëhequra nga gratë dhe t'i zhvillojë kapacitetet menaxhuese të grave;
5. të informojë në lidhje me vizionin dhe gatishmërinë afatshkurtër dhe afatgjatë të grave afariste.

Sipas statistikave të siguruara nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK), në Kosovë janë të regjistruara 54.412 entitete afariste, prej të cilave 31.220 janë ndërmarrje ndërsa 23.192 janë veprimtari afariste individuale. Këto veprimtari afariste janë të shpërndara në sektorët në vijim: në bujqësi, miniera dhe industri nxjerrëse, energji elektrike, gaz dhe furnizim me ujë, ndërtimtari, shitje me pakicë dhe shumicë, në sektorin e hotelarisë dhe restoranteve, transport, depo, komunikim, ndërmjetësim financiar, pronë e patundshme, arsim, në sektorin për mbrojtje sociale dhe shëndetësore dhe aktivitete të tjera shërbyese shëndetësore dhe personale.

Nga numri i përgjithshëm, vetëm 3.301 veprimtari afariste janë në pronësi të grave. Të dhënat nga qershori 2002 flasin për një rënie për 1.1 përqind të numrit të grave të regjistruara si pronare të veprimtarive afariste në krahasim me gjendjen e viti 2000 (6.1 përqind). Bazuar në aktivitetet sektoriale, shumica e veprimtarive afariste të udhëhequra nga gratë janë në sektorin e arsimit (15 përqind), shërbime financiare (14 përqind), mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, dhe shitje me shumicë dhe pakicë (8.2 përqind).<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Statistikë e Bizneseve të Regjistruara në Kosovë deri në dhjetor 2002, ZSK, mars 2003, p.18

Hulumtimi i bërë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në (Prishtinë, Gjilan, Pejë, Prizren dhe Ferizaj), tregon se ekziston një mosbarazim i madhe në mes të burrave dhe grave kur është fjala për pronësinë e veprimtarisë afariste. Ky hulumtim tregon se burrat dominojnë në sektorin e afarizmit (98 përqind), ndërsa vetëm 2 përqind të afarizmit formal në këto rajone janë në pronësi të grave.<sup>2</sup>

Ky hulumtim mbulon 1.450 gra ndërmarrëse të cilat udhëheqin afarizmin formal dhe jo formal në Kosovë. Shembujt kanë qenë të rastësishëm dhe të përbërë nga veprimtarit afariste të udhëhequra nga pjesëtar të komunitetit Shqiptar, Serb, Boshnjak, dhe Turk: 13.3 përqind të analizës mbulon gratë Serbe të Kosovës në këto komuna: Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, dhe Shtërpce, ndërsa 1.78 përqind të analizës përbëjnë gratë Boshnjake të Kosovës nga komuna e Dragashit.

Grumbullimi i të dhënave është bërë prej muajit Maj deri në muajin Tetor 2005, ndërsa intervistat u bënë gjatë tre muajve shtesë dhe u përfunduan në vitin 2006. U angazhuan tridhjetë hulumtuese nga secila komunë e Kosovës, duke përfshirë përfaqësuese të shoqatave të grave dhe studente të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Është aplikuar metoda kualitative dhe kuantitative në procesin e analizës.

Hulumtimi u krye në pesë faza:

- i. përgatitja e pyetësorëve bazuar në situatën e tregut dhe në vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë afariste në Kosovë;
- ii. identifikimi i grave afariste sipas përgatitjes profesionale në tridhjetë komunat e Kosovës, duke filluar me bizneset e vogla dhe të mesme në bujqësi, tregti, shërbime, artizanat, dhe industri;
- iii. Intervistat individuale me gratë pronare të sektorëve të ndryshëm të veprimtarive afariste formale dhe jo formale;

- iv. analiza e dokumenteve relevante të përgatitura nga institucionet gjegjëse vendore dhe ndërkombëtare (ZSK, MTI, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural);
- v. të dhëna të përpunuara në EXCEL dhe SPSS.

Gratë e Kosovës të cilat janë të afta për punë por janë të papunësuar përbëjnë 60 përqind. Proporcioni ndërmjet burrave është 1 me 1, ku 48 përqind të tyre janë të punësuar dhe 52 përqind janë të papunësuar. Varësia ekonomike është dy herë më e lartë në mesin e grave, kur merret për bazë fakti se 13 përqind e grave kundrejt 41 përqind e burrave jetojnë kryesisht nga të ardhurat e tyre personale, që vijnë nga puna e tyre. Përderisa 77 përqind e grave jetojnë nga të ardhurat e siguruara nga ndonjë person tjetër, e njëjta gjendje prek vetëm 33 përqind meshkujt.

Të dhënat statistikore gjithashtu tregojnë se shkalla e papunësisë në mes të burrave dhe grave nuk është e njëjtë. Raporti i përgatitur në vitin 2003 nga Departamenti për Punë dhe Punësim në MPMS, tregon se 75 përqind e të gjithë personave të papunë të cilët kanë gjetur punë nëpërmjet enteve për punësim janë burra kurse 25 përqind janë gra.

<sup>2</sup>Raport nga hulumtimi në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, MIT, dhjetor 2004, fq.11

<sup>3</sup>Raporti vjetor, Puna dhe Punësimi, Departamenti i Punës dhe Mirëqenies Sociale, MPMS, 2004, fq. 20

Të gjitha këto shifra tregojnë se gratë janë akoma të diskriminuara kur është fjala për avancimin ekonomik dhe janë të pabarabarta në qasje dhe në realizimin e të drejtave të tyre në burime për pavarësinë ekonomike.

Stagnimi i ekonomisë dhe vonesa e zhvillimit ekonomik shihen si problem kryesor në Kosovë, edhe pse gratë janë më së shumti të dëmtuara në këtë aspekt, kjo çështje nuk është vështruar drejtpërsëdrejti. Meqenëse gratë përbëjnë përqindjen më të madhe të të punësuarave në ndërmarrjet shoqërore, tani të lëna në mëshirën e privatizimit ato janë të goditura më së shumti nga transformimi nga ekonomia shoqërore në atë të tregut. Në përpjekjen për të kompensuar këto rrethana, gratë e Kosovës janë munduar të themelojnë ndërmarrjet e tyre të vogla dhe të mesme, mirëpo institucionet kyçe deri këtu kanë dështuar në përkrahjen e përpjekjeve të tilla.

Rezultatet e këtij studimi pra i adresohen hartuesve të politikave dhe atyre të vendim marrjes me qëllim të:

- vetëdijesimit të aktorëve qeveritarë, institucioneve bankare, investitorëve dhe anëtarëve të shoqërisë civile, për ndikimet gjinore të zhvillimit ekonomik;
- fitimit të përkrahjes për krijimin e një ambienti të favorshëm për zgjerimin e bizneseve të grave dhe krijimin e mundësive të barabarta për punë;
- stimulimit të konfrontimeve në identifikimin e pabarazive aktuale për të përkrahur iniciativat ndërmarrëse të grave;
- shtytjes për një përgjigje efikase për sfidat gjinore që kanë të bëjnë me ekonominë e tregut;
- inspirimit dhe krijimit të mekanizmave që ju mundësojnë grave që të marrin pjesë dhe të ndikojnë në formimin e politikave makroekonomike;
- lidhjes së bashkësive afariste të grave me organizatat shoqërore dhe private dhe lehtësimin e partneritetit ndërmjet tyre;
- krijimin e bazës së të dhënave të përhershme për gratë ndërmarrëse të Kosovës dhe të aktiviteteve me të cilat ato udhëheqin dhe menaxhojnë.

Për t'i tejkalar pabarazitë në punë, në treg dhe ekonomi, duhet të nxirren dispozita për t'i përfshirë interesat strategjike të grave në politikat gjegjëse dhe në mënyrë pro-aktive të

mbështetet punësimi i grave dhe aktivitetet ndërmarrëse të tyre. Kjo mund të arrihet duke mbështetur programet të cilat do t'ju mundësonin grave afariste të kenë qasje në inkubator, kredi fleksibile dhe në trajnime thelbësore për shkathtësi. Është me rëndësi që të ngritën zërat e fuqishëm avokues në nivelet e politikave publike për të forcuar pozitën e grave në ekonomi.


**Mirlinda Kusari**  
Kryetare,  
Shoqata Afariste e Gruas  
SHE-ERA

**Maddalena Pezzotti**  
Shefe, Zyra për Çështje Gjinore  
UNMIK

## Kapitulli 1

### Llojet e aktiviteteve afariste

Sipas llojit të veprimtarisë të cilën e ushtrojnë gratë afariste të Kosovës, bazuar në hulumtim nga totali i përgjithshëm kemi një pasqyrë të të dhënave ku numri më i madh i subjekteve afariste ku pronare janë gratë është i përqendruar në veprimtari shërbyese dhe tregtare, dhe vetëm një përqindje e vogël e tyre merren me prodhim. Hulumtimi ka treguar se vetëm një numër i vogël i grave operojnë në sektorin e bujqësisë. Marrja me bujqësi e grave me të madhe është lënë anash në mungesë të mjeteve financiare, fondeve për projekte të cilat krijojnë të hyra, dhe në mungesë të përkushtimit të institucioneve vendim marrëse (MBZHR) për gratë fermer. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat e siguruara nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK), në raport lidhur me bizneset e regjistruara në vitin 2002. Raporti dëshmon se vetëm 13 subjekte afariste në fushën e bujqësisë nga totali i përgjithshëm prej 3.301 subjekteve afariste në gjithë territorin e Kosovës, menaxhohen nga gratë fermer nga viset rurale.



**Fig 1. Struktura sipas veprimtarive**


Nga totali i përgjithshëm i grave të anketuara, vetëm 4 përqind e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e bujqësisë (blegtori dhe agrikulturë), 15 përqind ushtrojnë veprimtari prodhuese (prodhimet e tekstilit, ndërresa të brendshme, uniforma, produkte të qumështit, konservime të



primeve, furra të bukës, prodhime të qilimave tradicional, fustane të nusërisë, etj), dhe pjesa dërmuese e tyre janë të përfshira në aktivitete shërbyese dhe tregtare, ku 38 përqind ofrojnë aktivitete shërbyese dhe 43 përqind aktivitete tregtare.

### **Llojet e bizneseve shërbyese**

Përgjigjet në këtë pyetje janë të ndara sipas llojit të veprimtarisë shërbyese që ofrojnë.




**Fig. 1.1. Bizneset shërbyese**

Sipas këtyre të dhënave, aktivitetet specifike të subjekteve afariste shërbyese të grave klasifikohen në kategoritë si vijon: floktari 44 përqind, 27 përqind sallone të bukurisë (tretman të fytyrës, rregullimin e thonjve etj.), shërbime shëndetësore 8 përqind (farmaciste, gjinekologe, stomatologe, optika, etj.), menaxhere të filialeve të kompanive të sigurimit janë 3 përqind, menaxhere të kopshteve për fëmijë 8 përqind, menaxhere të agjencive turistike 4 përqind, pronare të internet kafeve 3 përqind dhe instruktore të auto shkollave 3 përqind.

### **Llojet e bizneseve tregtare**

Sa i përket bizneseve tregtare të cilat menaxhohen nga gratë, të dhënat tregojnë se të gjitha gratë merren me tregti me pakicë. Kjo shpjegon se gratë afariste në Kosovë nuk kanë mundësi të merren me tregti me shumicë, me të cilën merren kryesisht vetëm meshkujt. Kjo ndodhë për shkak se gratë nuk kanë kapital të nevojshëm për të investuar dhe zgjeruar veprimtarin e tyre afariste.




**Fig. 1.2. Bizneset tregtare**

Nga të dhënat e përgjithshme shohim se 20 përqind e grave merren me tregti të produkteve ushqimore, 35 përqind shesin produkte të tekstit (veshmbathje), 15 përqind shesin produkte të kozmetikës, 5 përqind shesin material për shkolla dhe zyrë, dhe 25 përqind shesin mallra të përzier (këpucë, çanta, mallra kinez etj.).

### Llojet e bizneseve bujqësore

Edhe pse pjesa dërmuese e popullsisë së Kosovës jetojnë në zonat rurale, vetëm 4 përqind të grave të anketuara merren me bujqësi. Sipas situatës së tanishme, kemi një mungesë të përkrahjes nga institucionet lokale për zhvillim rural, veçanërisht lidhur me përkrahjen e grave fermerë me fonde dhe ndarjen e buxhetit në baza gjinore. Këtë e tregon më së miri figura 1.3.




**Fig. 1.3. Bizneset bujqësore**

Nga totali i përgjithshëm i grave të përfshira në bujqësi 60 përqind kultivojnë lule, fidanë, specat, tranguj, domate, etj. 30 përqind merren me blegtori dhe shpestarti ku pjesa dërmuese e tyre posedojnë me ferma të vogla të pulave dhe zogjve, ferma të lopëve dhe gjedhëve dhe vetëm 10 përqind merren me bletari.

### **Llojet e bizneseve përpunuese/prodhuese – industria e lehtë përpunuese**

Në këtë kategori, gratë të cilat merren me aktivitete afariste përpunuese/prodhuese të produkteve të ndryshme i kemi kategorizuar në 5 grupe:

- Tekstil – ky grup përfshin gratë të cilat posedojnë ndërmarrje të vogla të cilat merren me prodhimin e kostumeve të femrave dhe meshkujve, uniforma të shkollave dhe institucioneve, ndërresa të brendshme për femra dhe meshkuj, fustane të nusërisë etj.
- Punëdore – ky grup përfshinë të gjitha produktet e prodhuara nga gratë, siç janë: qilimat e vekut, çanta, veshje kombëtare, qëndisje, garnitura të ndryshme me grep etj.
- Prodhimet dhe përpunimi i qumështit – përfshinë të gjitha përpunimet e qumështit siç janë: djathi, gjiza, jogurti, kosi, etj.
- Furrat e bukës – përfshijnë të gjitha llojet e brumërave, siç janë: bukë e thekës, petë, biskota, etj.
- Përpunimi i perimeve dhe konservimi – përfshinë të gjitha perimet të cilat janë përpunuar dhe konservuar siç janë: specat, domatet, trangujt, lakrat, kërpudhat, hajvari, etj.



**Fig. 1.4. Industria e lehtë përpunuese**


Nga të dhënat e përmendura më lartë dhe informatat nga sektorët e ndryshëm, nga numri i përgjithshëm 35 përqind e grave punojnë në kategorinë e tekstit, 29 përqind merren me punëdore, 12 përqind merren me prodhime dhe përpunime të produkteve qumështore, 9

përqind disponojnë me furra të bukës dhe 15 përqind merren me përpunimin dhe konservimin e perimeve.

## Kapitulli 2

### Numri i të punësuarve

Pjesa dërmuese e grave janë përgjigjur se nuk kanë asnjë të punësuar të jashtëm, por sigurojnë ndihmë nga anëtarët të familjes.



**Fig. 2. Numri i të punësuarve**


56.3 përqind janë përgjigjur se nuk kanë asnjë të punësuar d.m.th të gjitha aktivitetet afariste i kryejnë vet, 40.3 përqind kanë 1-4 të punësuar, 2.7 përqind kanë 5-9 të punësuar, 0.3 përqind kanë mbi 10-49 të punësuar dhe vetëm 0.1 përqind ka mbi 50 të punësuar. Kjo tregon se ekziston një numër shumë i vogël i bizneseve të mesme, dhe se shumica e femrave afariste në

Kosovë merren kryesisht vetëm me biznes të vogël dhe kanë një numër të kufizuar të punëtoreve ose nuk kanë fare të punësuar.

### Kapitulli 3

#### **Kohëzgjatja e aktiviteteve afariste**

Informatat e mbledhura tregojnë se shumica e aktiviteteve afariste ka filluar pas mbarimit të luftës në vitin 2000, mirëpo ekzistojnë edhe disa të dhëna tjera të cilat tregojnë se disa gra të Kosovës kanë filluar bizneset e tyre edhe para dhjetë apo më shumë viteve.




**Fig. 3. Vitet e aktivitetit afarist**

12.1 përqind janë përgjigjur se biznesi i tyre është fillestar. 24.5 përqind i zhvillojnë aktivitetet e tyre afariste 1 deri në 2 vite. 33.3 përqind janë përgjigjur se aktivitetin afarist e zhvillojnë 2 deri në 5 vite. 14 përqind janë përgjigjur se aktivitetin afarist e zhvillojnë prej 5 deri në 10 vite, ndërsa 16.1 përqind tregojnë se aktivitetin afarist e zhvillojnë mbi 10 vite.

### Kapitulli 4

## Vendndodhja e zhvillimit të aktiviteteve afariste

Shumica e femrave tregojnë se aktivitetet e tyre afariste i zhvillojnë në shtëpitë e tyre. Kjo ndodhë për shkak të mungesës së mjeteve financiare për huazimin e ndonjë objekti, dhe në disa raste gratë duhet të qëndrojnë pranë fëmijëve për shkak të mungesës së kopshteve për fëmijë.




**Fig. 4. Vendi i kryerjes së aktivitetit afarist**

31.6 përqind e grave e zhvillojnë aktivitetin e tyre afarist në shtëpitë e tyre sepse ato nuk kanë mjete të paguajnë qiranë, por disa prej tyre duhet të jenë afër familjeve pasi që duhet të përkujdosen për fëmijët. Kjo tregon, se përveç përgjegjësive afariste, gratë duhet të përkujdosen për mirëmbajtjen e shtëpisë dhe për fëmijët e tyre. 11.9 përqind i zhvillojnë aktivitetet afariste në objektet e tyre afariste, 51.5 përqind e të anketuarave i zhvillojnë aktivitetet afariste në qytetin apo në fshatin ku banojnë, dhe 4.9 përqind e të anketuarave janë përgjigjur se aktivitetet e tyre afariste i zhvillojnë në ndonjë qytet apo fshat tjetër.

## Kapitulli 5

### Vendndodhja e konsumatorëve

Sa i përket vendndodhjes së konsumatoreve, pjesa dërmuese e grave afariste janë përgjigjur se tregu për produktet e tyre zakonisht është vendor.




**Fig. 5. Vendndodhja e konsumatorëve**

Nga numri i përgjithshëm i grave të anketuara, 81 përqind theksuan se vendndodhja e konsumatorëve kryesisht është në vendet ku zhvillojnë aktivitetet e tyre afariste. 16 përqind janë përgjigjur se konsumatorët e tyre e kanë vendndodhjen në zonat e njëjta rajonale, dhe vetëm 3 përqind e prodhimeve dhe shërbimeve të cilat menaxhohen nga gratë eksportohen jashtë vendit, kryesisht në Shqipëri, Maqedoni dhe një numër i vogël i artizanaleve (3 përqind) eksportohen në vendet e Evropës perëndimore.

## **Kapitulli 6**

### **Vendndodhja e ofruesve të shërbimeve afariste**

Përkundër faktit se pjesa dërmuese e grave të anketuara janë deklaruar se ofruesit e shërbimeve për nevojat e tyre afariste gjenden afër, prapë paraqitet një problem për gratë në zonat rurale. Gratë e zonave rurale janë të obliguara të shpenzojnë më shumë kohë dhe para për të plotësuar kërkesat afariste në krahasim me gratë e zonave urbane.



**Fig. 6. Vendndodhja e ofruesit të shërbimeve afariste**


40.4 përqind e grave të anketuara nuk kanë nevojë të shpenzojnë kohë shtesë për të plotësuar nevojat afariste dhe për tu takuar me ofruesit e shërbimeve për nevojat e tyre. 29 përqind kanë deklaruar se duhet të udhëtojnë deri në 5 kilometra, 23 përqind deri në 20 kilometra, kurse 7.9 përqind (kryesisht nga viset rurale) udhëtojnë mbi 20 kilometra.

## **Kapitulli 7**

### **Koha e cila i përkushtohet aktivitetit afarist**

7 përqind e grave janë përgjigjur se punojnë 10 orë në javë, 6.3 përqind punojnë 10 deri 20 orë në javë, 9.3 përqind punojnë 20 deri 34 orë, 33.9 përqind punojnë 35 deri 50 orë në javë, 29.3 përqind punojnë 50 deri 75 orë në javë dhe 14.2 përqind punojnë mbi 75 orë në javë.






**Fig. 7. Orët e punës për javë**

## **Kapitulli 8**

### **Motivi për të filluar veprimtarin afariste**

Ekzistojnë motive të ndryshme të cilat i kanë shtyrë gratë që të fillojnë veprimtarin e tyre afariste. Nga përgjigjet, shihet qartë se njëra nga arsyt kryesore për gratë kosovare është situata e varfër ekonomike, sidomos gjatë periudhës së tranzicionit dhe privatizimit. Të ngadalshëm. Mundësia për krijimin e të ardhurave për të mbajtur vetveten dhe familjet e tyre është një nga motivet primare që gratë i ka shtyrë të fillojnë veprimtarin afariste.




**Fig 8. Motivi kryesor për të filluar veprimtarin afarist**

27 përqind kanë filluar veprimtarin afarist për të mbajtur familjen, 25 përqind për krijimin e të ardhurave sekondare, 7 përqind janë kyçur në aktivitete afariste për arsye të kohës së lirë në dispozicion, 10 përqind janë përgjigjur se kanë shpirt ndërmarrës dhe gjithmonë kishin një ëndërr për të zhvilluar një veprimtari afariste, 17 përqind janë deklaruar se zhvillojnë veprimtarin afariste për ta mbajtur veten aktive, 4 përqind kanë filluar veprimtarin afariste pasi kanë qenë të frymëzuara nga familja, dhe 10 përqind e kanë filluar veprimtarin afariste e tyre për shkak të pamundësisë të punësimit të tyre diku tjetër.

## Kapitulli 9

### **Qëllimi kryesor i veprimtarisë afariste**

Qëllimi kryesorë për të filluar veprimtarin afariste është gjenerimi i të ardhurave të rregullta dhe të vazhdueshme, ose krijimi i një pasurie e cila do të trashëgohet nga fëmijët e tyre. Një numër shumë i vogël i grave afariste si qëllim primarë ka depërtimin në tregun ndërkombëtar, mirëpo për momentin, për shkaqe të mungesës së mekanizmave dhe legjislacionit, është e pamundur të arrijnë këtë, me përjashtim të disa grave të cilat merren me punëdore dhe artizanat.




**Fig. 9. Qëllimi i afarizmit**

59 përqind e kanë veprimtarin afariste me qëllim që të krijojnë të hyra rregullta dhe të vazhdueshme; 13 përqind dëshirojnë të krijojnë pasuri valide; 16 përqind dëshirojnë të zhvillojnë veprimtari afariste të cilin do ta trashëgojnë fëmijët e tyre; 8 përqind e tyre si qëllim kryesor e kanë depërtimin në tregun e brendshëm, ndërsa vetëm 4 përqind tregojnë ambicie afariste dhe pretendojnë që të depërtojnë në tregun ndërkombëtarë.

## **Kapitulli 10**

### **Përgjegjësia vendim marrëse**

Pjesa më e madhe e grave janë përgjigjur se e kanë përgjegjësin për marrjen e vendimeve, ndërsa një numër i vogël i tyre nuk kanë aftësi vendim marrëse (frikohen të marrin vendime) dhe varësisht nga rasti, vendimet merren nga partneri në biznes apo burri.




**Fig. 10. Marrja e vendimeve**

Nga 1450 të intervistuar, 75 përqind i marrin vetë vendimet lidhur me veprimtarin e tyre afariste, dhe 25 përqind e të intervistuarave kanë deklaruar se vendimet për afarizmin e tyre i merr dikush tjetër ndonëse ato janë pronare të vetme ose të përbashkëta të veprimtarisë afariste.

### **Vendim marrësit kryesorë në afarizëm**

Nga të dhënat e figurës 10, shohim se nga totali i përgjithshëm i të intervistuarave, 25 përqind e tyre edhe pse janë bashkëpronare nuk i marrin vendimet vetë. Këtë e ilustron më së miri me të dhënat e dala nga të intervistuarat duke marrë për bazë alternativën se kush është vendimmarrës për biznesin e tyre.




**Fig. 11. Vendim marrësit kryesorë**

Nga numri i përgjithshëm i rasteve ku gratë nuk janë vendim marrëse kryesore, 54 përqind të rasteve kanë bashkëpronarët e përbashkët (burrat) të cilët marrin vendime, në 20 përqind të rasteve vendimet merren nga vëllezërit si bashkëpronar, në 2.5 përqind të rasteve djemtë e tyre marrin vendime, në 2.3 përqind të rasteve vendimet i marrin vajzat e tyre, në 1.7 përqind të rasteve vendimet i merr vjehrra e tyre dhe në 0.3 përqind të rasteve vendimet i merr vjehri i tyre. Kurse 19.2 përqind janë përgjigjur se pronar apo vendimmarrës është dikush tjetër jashtë alternativave të mundshme si babai, nëna, shoku, shoqja, partneri afarist etj.

## **Kapitulli 11**

### **Ndërthurja e familjes dhe veprimtarisë afariste**

Gratë afariste në Kosovë nuk dallojnë nga gratë tjera pronare të subjekteve afariste ku ato në përgjigjet e tyre thonë se përkrahja e familjes është kritike për të zhvilluar një veprimtari. Të gjitha gratë e intervistuar janë përgjigjur se hapja dhe funksionimi i biznesit të tyre nuk do të ishte i mundur pa përkrahjen e familjes dhe komunitetit të tyre në përgjithësi. Kjo ka të bëjë sidomos me iniciativat e grave ndërmarrëse për të filluar biznesin e tyre. Për zhvillimin e biznesit nevojitet një përkushtim më i madh i kohës, e në këtë rast gratë kanë obligime të tjera rreth punëve të shtëpisë dhe përkujdesjes ndaj edukimit të fëmijëve.




**Fig.12. Mbështetja e familjes**

Nga figura 12 shohim se 36 përqind e grave afariste të intervistuar kanë mbështetje të plotë duke përfshirë edhe përkrahjen morale. Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre afariste ato kanë përkrahje teknike, përkrahje në hulumtim të tregut, furnizim me mall, etj. 52 përqind e tyre kanë mbështetje morale, mirëpo punët kryesore duhet ti kryejnë vetë, 8 përqind janë përgjigjur se anëtarët e familjes i ndihmojnë. Vetëm 4 përqind janë deklaruar se të gjitha punët duhet ti kryejnë vetë dhe nuk kanë mbështetje morale dhe teknike.

### **Rëndësia e biznesit për familjen**

Të anketuarat kanë theksuar se biznesi ka një rëndësi mjaftë të madhe sepse të hyrat e gjeneruar iu ndihmojnë të përmirësojnë standardin e tyre jetësor dhe të familjes së tyre, dhe njëkohësisht sigurojnë pavarësinë e tyre ekonomike.



**Fig. 13. Rëndësia e veprimtarisë afariste**


31 përqind e grave kanë deklaruar se biznesi i tyre ka rëndësi mjaftë të madhe, dhe se ato nuk do të kishin mbijetuar pa të, 62 përqind kanë deklaruar se biznesi i tyre është i vlefshëm dhe ishte i nevojshëm ta fillojnë në mënyrë që të kenë të hyra dhe një standard më të lartë jetësor, 3 përqind janë deklaruar se biznesi është vetëm pengesë në familje, sepse ju shkakton probleme për tu kthyer mbrapa për arsye të humbjeve të cilat i kanë pasur gjatë zhvillimit të biznesit të tyre, mirëpo përkundër vështirësive me të cilat përballen, ato vazhdojnë të mbajnë veprimtarin e tyre afariste me shpresë se në të ardhmen do të kenë sukses. Në kategorinë “Të tjera”, 4 përqind e të intervistuarave kanë dhënë këto komente:

- “Ka vlerë të madhe për mua në aspektin profesional”
- “Pasi që më krijon të ardhura financiare personale, është i vlefshëm për mua personalisht”
- “Nuk dëshirojë të jem barrë e dikujt, dëshirojë të mbajë vetveten”

## Kapitulli 12

### **Pengesat dhe vështirësitë**

Pengesat me të cilat ballafaqohen gratë afariste në Kosovë janë të shumta, por pjesa dërmuese e të anketuarave janë përgjigjur se pengesa më e madhe për rritjen e afarizmit të tyre janë obligimet dhe përgjegjësit familjare.



**Fig. 14. Zhvillimi i biznesit - pengesat**

Sipas përgjigjeve nga intervistat, 25 përqind e grave të anketuara kanë deklaruar se pengesë kryesore janë obligimet familjare. Përveç menaxhimit të veprimtarisë afariste, ato kanë edhe shumë obligime të tjera familjare në krahasim me meshkujt (punët e shtëpisë, përgatitja e

ushqimit, pastrimi dhe përkujdesja ndaj fëmijëve), gjë që e bënë punën e tyre më të rëndë dhe është një ndër barrierat kryesore për ato. 8 përqind e grave nuk qëndrojnë mirë me shëndet dhe janë mjaftë të stresuar gjatë gjithë kohës, por janë të detyruara të vazhdojnë me veprimtarin e tyre afariste sepse nuk kanë burim tjetër të ardhurave në familje. 2 përqind kanë deklaruar se pengesë kryesore e tyre është frika se a do të kenë sukses me afarizmin e tyre apo jo, 6 përqind nuk kanë aftësi të nevojshme për menaxhimin dhe zhvillimin e afarizmit të tyre, dhe kanë deklaruar se kanë mungesë të njohurive për menaxhim dhe kanë nevojë për këshilla, konsultime dhe trajnime për ngritjen e kapaciteteve të tyre menaxhuese. 7 përqind kanë deklaruar se kanë mungesë të kërkesës për produkte dhe shërbime që ato i ofrojnë (mungesë të tregut).


Problem tjetër me të cilin ballafaqohen është largësia e tregut ku shesin e produktet e tyre. 6 përqind e grave të intervistuar, sidomos ato në zonat rurale janë përgjigjur se kjo paraqet një problem. 8 përqind kanë deklaruar se objekti ku ato e zhvillojnë biznesin e tyre paraqet pengesë për zhvillimin dhe rritjen e biznesit. 8 përqind të tjera kanë deklaruar se mungesa e hapësirës së mjaftueshme për zhvillimin e biznesit të tyre paraqet problem. 2 përqind kanë deklaruar se mungesa e stafit të aftë gjithashtu paraqet problem, përderisa 20 përqind e grave afariste kanë deklaruar se problemi i tyre është mungesa e mjeteve financiare. Sipas grave të intervistuar kushtet e kreditimit të ofruara nga bankat në Kosovë nuk janë stimuluese dhe nuk e përkrahin zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. 4 përqind i shohin si pengesë kryesore politikat fiskale, mungesën e shumë ligjeve dhe mos implementimin e ligjeve ekzistuese. Së fundi, 4 përqind e tyre si pengesë e shohin importin e paligjshëm (ilegalë) të produkteve të ndryshme të pakontrolluara dhe konkurrencën jo lojale në tregun e Kosovës.

## **Kapitulli 13**

### **Këshillat afariste**

Pjesa më e madhe e grave afariste, janë shprehur se marrin këshilla për biznesin e tyre nga bashkëshortët.






**Fig. 15. Këshillat dhe konsultimet**

45 përqind e grave afariste marrin këshilla afariste nga bashkëshortët e tyre, 23 përqind nga partnerët afarist, ndërsa 5 përqind nga kontabilistët ose këshilltarët financiarë, 4 përqind nga institucionet bankare dhe mikrofinanciare, siç janë: FINCA, KEP, Besëlidhja etj. 1 përqind nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), 10 përqind nga shoqatat afariste, 5 përqind nga trajnuesit/mentorët e biznesit, dhe 7 përqind nga miqtë, kolegët etj.

## **Kapitulli 14**

### **Ardhmëria e veprimtarisë afariste**

Pas aparthedit të vitit 1999 e deri më sot, ekonomia në Kosovë vazhdon të jetë e pafavorshme për të gjeneruar dhe përkrahur zhvillimet e reja ekonomike. Kjo është pasojë e ambientit të pavolitshëm për fillimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, statusit të pa definuar i Kosovës, procesit të ngadalshëm të privatizimit (ku një numër i madh i grave kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet shoqërore), kushteve të kreditimit, politikave fiskale, doganore dhe tatimore, mungesës së ligjeve, infrastrukturës, energjisë elektrike, licencimit, etj. Për këtë shkak, një pjesë e konsiderueshme e grave janë përgjigjur se do ta mbyllnin biznesin e tyre për një punë më të mirë.




**Fig. 16. Ardhmëria e veprimtarisë afariste**

Të dhënat tregojnë se 28 përqind e grave kanë deklaruar se do ta mbyllin veprimtarin e tyre afariste nëse ju ofrohet një punë më e mirë. Sipas komenteve të tyre, deri te kjo vjen nga mungesa e mjeteve financiare për zhvillimin e biznesit të tyre, mungesa e tregut, dhe konkurrenca jo-lojale e krijuar me importimin e produkteve. 54 përqind kanë deklaruar se do të vazhdojnë biznesin e tyre edhe përkundër të gjitha vështirësive me të cilat ato përballen, ndërsa 18 përqind tregojnë ndjenja të përziera.

## **Kapitulli 15**

### **Trajnimi dhe zhvillimi**

Fatmirësisht pas luftës, me vërshimin e organizatave ndërkombëtare dhe themelimin e OJQ-ve vendore e gjithë popullata e Kosovës është ndihmuar në mënyra të ndryshme si në ndërtimin e objekteve të shkatërruara gjatë luftës, infrastrukturës, ndërtimin e institucioneve dhe ngritjen kapaciteteve humane. Donacionet e bënë të mundur plotësimin e boshllëqeve dhe avancimin e trendëve zhvillimore dhe aplikimin e teknologjisë bashkëkohore deri diku si në të gjitha vendet e tranzicionit. Kjo mundësi iu ofrua grave të Kosovës, nëpërmjet të trajnimeve për zhvillimin e aftësive të tyre në: planifikimin e biznesit, menaxhment, marketing, financa, teknologji informative/kompjuter, zhvillim të karrierës, dhe përkrahje teknike nga ekspert vendorë dhe ndërkombëtar. Gjithashtu është e rëndësishme të përmenden edhe shumë vizita studimore në vendet e zhvilluara dhe në tranzicion, të cilat kanë ndihmuar mjaftë që përvojat e tyre ti sjellin dhe ti adaptojnë në Kosovë. Mirëpo, përkundër të gjitha këtyre ndihmave dhe mbështetjeve, gratë e intervistuarat treguan se pjesa më e madhe e tyre nuk kanë pasur rast të ndjekin këto trajnime.




**Fig. 17.**

14 përqind kanë deklaruar se iu është ofruar përkrahje teknike në aktivitetet e tyre prodhuese/përpunuese dhe shërbyese nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, përderisa 32 përqind e grave në biznes kanë deklaruar se nuk kanë ndjekur asnjë nga këto trajnime të ofruara. 10 përqind deklarojnë se kanë ndjekur kurse të marketingut, 12 përqind kurse të teknikave të shitjes, 8 përqind deklarojnë se kanë ndjekur kurse dhe seminare për zhvillim të karrierës, 3 përqind kanë ndjekur seminare për zhvillimin e resurseve humane, 4 përqind kanë ndjekur për plan të afarizmit, 3 përqind kanë deklaruar se kanë ndjekur kurse për menaxhim të financave, 6 përqind kanë ndjekur kurse për menaxhimin e projekteve dhe 8 përqind kanë deklaruar se kanë pasur mundësi të ndjekin seminare për teknologjinë informative.

### **Zhvillimi i aftësive afariste**

Gratë e anketuara janë përgjigjur se kanë mundësi të ndryshme sa i përket zhvillimit të aftësive të tyre afariste sidomos përmes ofruesit të shërbimeve, konsulentëve, rrjeteve të ndryshme afariste, institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare, hulumtimeve përmes internetit dhe trajnimeve sipas nevojës etj.




**Fig. 18. Zhvillimi i aftësive në afarizëm**

Nga figura shohim se pjesa më e madhe e grave të intervistuar, (41 përqind) janë përgjigjur se kanë ndjekur seminare me qëllim që të zhvillojnë aftësitë e tyre afariste, 13 përqind përmes trajnimeve dhe mentorëve, 10 përqind i kanë rritur aftësitë e tyre përmes kontakteve me rrjetet e bizneseve (këshillimeve, informatave etj), 14 përqind aftësohen përmes literaturës afariste, 2 përqind përmes programeve softuerike në CD, varësisht nga nevojat që i kërkon aktiviteti i tyre, 6 përqind përmes leximit dhe përcjelljes së gazetave, 2 përqind aftësohen përmes informatave në internet, 2 përqind përmes studimeve me korrespondencë, dhe 10 përqind përmes trajnimeve të kohës (kur shfaqet nevoja).

### **Pengesat për përmirësimin e aftësive në biznes**

Trajnimet për ngritjen e kapaciteteve menaxhuese janë mjaftë të rëndësishme për çdo afarist/e, sidomos në rrethinën aktuale ekonomike ku trendët dhe ngritja e aftësive duhet të përcillen dhe integrohen në secilin planifikim të biznesit. Përkundër dëshirës së grave në Kosovë për të qenë pjesë e një ekonomie moderne, është vështirë që të ndajnë kohën për ngritjen e aftësive profesionale, për shkak të përgjegjësisë familjare, mungesës së mjeteve financiare, shpenzimeve të trajnimit, etj.




**Fig. 19. Faktorët të cilët ndikojnë në veprimtarin e tyre afariste**

Sipas të dhënave nga figura 19, pjesa dërmuese e grave afariste, (44 përqind) kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë pengesë për avancimin e tyre, 24 përqind kanë deklaruar se përveç aktivitetit të tyre afarist ato duhet të përkujdesen për familjet e tyre (sidomos gratë kryefamiljare), 6 përqind kanë deklaruar se kanë vështirësi të ndjekin trajnime sepse trajnimet nuk mbahen në vendin ku ato jetojnë dhe veprojnë, 5 përqind kanë deklaruar se çmimi i trajnimeve të cilat ofrohen është i lartë, ndërsa 21 përqind kanë deklaruar se nuk mund të përcjellin trajnimet në mungesë të mjeteve financiare.

### **Trajnimet e kërkuara për biznes**

Një përqindje e lartë e grave përgjigjen se në mungesë të aftësive profesionale menaxhuese, falimentimi i afarizmit është bërë i zakonshëm. Ky fenomen tregon domosdoshmërinë për ofrimin e shërbimeve, trajnimeve dhe konsultimeve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të grave.




**Fig.**

## 20.

10 përqind e grave janë përgjigjur se kanë nevojë për përkrahje teknike për të zhvilluar biznesin e tyre. 12 përqind kanë thënë se kanë nevojë të ngritin kapacitetet e tyre në fushën e marketingut. 15 përqind kanë nevojë të aftësohen për teknikat e shitjes. 15 përqind janë deklaruar se kanë nevojë për trajnime të zhvillimit të karrierës. 7 përqind kanë nevojë të ndjekin trajnime për resurse humane (punësim dhe menaxhim me njerëz). 9 përqind janë deklaruar se ju nevojiten kurse për të zhvilluar biznesin e tyre. 7 përqind menaxhment financiar. 8 përqind janë deklaruar për kurse të menaxhimit të projekteve. 7 përqind të tjera se kanë nevojë për kurse të teknologjisë informative (kurse të kompjuterëve, krijimin e faqes së internetit etj), dhe vetëm 10 përqind kanë deklaruar se kanë nevojë të ndjekin kurse por nuk mundën ta bëjnë këtë për shkak të moshës dhe problemeve shëndetësore.

### **Interesimi për përmirësimin e aftësive në biznesit**

Pjesa dërmuese e grave kanë deklaruar se e kuptojnë rëndësinë e ngritjes së aftësive profesionale dhe menaxhuese dhe si nevojë për të promovuar afarizëm të qëndrueshëm.



**Fig. 21.**

82 përqind e grave kanë deklaruar se janë shumë të interesuara që të avancojnë aftësitë e tyre profesionale, 9 përqind janë përgjigjur se nuk janë shumë të interesuara sepse kanë aftësi të duhur menaxheriale, dhe 9 përqind kanë deklaruar se nuk janë fare të interesuara.

## **Kapitulli 16**

### **Studime rasti të grave të suksesshme afariste të Kosovës**

#### **Afërdita Saraqini Kelmendi – Drejtoresh e Përgjithshme e RTV 21 Lufta për lirinë e shtypit në Kosovë**

Gjatë viteve të 80-ta kam punuar si gazetare dhe redaktore ne Radio Prishtinë. Me shkatërrimin e institucioneve të Kosovës nga ana e Serbisë, me 5 Korrik 1990, u detyrova që ta lëshojnë punën sikurse edhe kolegët e mi. Megjithatë, unë nuk munda të braktisë pasionin tim për gazetarinë, kështu që në vitet e 90-ta fillova të punojë si reportere për Radion Ndërkombëtare në Francë dhe pastaj për radion “Zëri i Amerikës”.

Pasi që isha e vetëdijshme për vlerën e informatave dhe shpresoja për një të ardhme kur të fillojë të funksionojë shtypi i lirë, unë mendoja për gazetaret e ardhshëm. Në vitin 1995, në banesën time prej 38 m<sup>2</sup>, e themelova Qendrën për aftësi komunikimi, me qëllim të ofrimit të

trajtimeve në komunikim, radio dhe televizion. 84 femra morën pjesë në këto trajtime. Gazetarët e rinj menjëherë filluan të punojnë. Në vitin 1997, ata filluan me redaktimin e revistës së femrave "Eritrea", e mbështetur nga USAID-OTI.

Në të njëjtin vit, në bashkëpunim me kolegët, gazetarë dhe inxhinierë, unë përgatita projektin për hapjen e një stacioni radio - televiziv të cilin e paraqita në USAID. Aty më bënë pyetjen: "A keni për qëllim të hapni një stacion TV në New York apo Tokio? Unë u thash, jo, do ta hapi në Prishtinë. Gjithashtu u thashë që me ndihmën e tyre do të përparonim më shpejtë kurse pa përkrahjen e tyre do të avanconim më ngadalë, por megjithatë do t'ia dilnim mbanë. USAID-i vendosi të na mbështetë dhe e shfrytëzova legjislacionin e atëhershëm në fuqi që të bëjmë transmetimin e programeve përmes internetit. Këta ishin hapat e parë.

Në Prill të vitit 1998, Media Projekt startoi me Radio 21, radio e parë shqiptare në internet e cila transmetonte lajmet në gjuhën Shqipe dhe Angleze. Ndërkohë, në bashkëpunim me Internews, unë dhe kolegët e mi transmetuam në mbarë botën 12 filma të shkurt, disa prej të cilëve u shfaqen edhe në CNN World Report. Në Janar 1999, pas transmetimit në internet, Radio 21 arriti të ketë edhe një kryeartikull informativ prej 15 minutave, përmes programit satelitor BBC World.

Mirëpo, në Mars të vitit 1999, me fillimin e bombardimeve të NATO-s në Kosovë, Radio 21 ndërpreu punën. Por unë dhe kolegët e mi vazhduam të transmetonim lajme për botën e jashtme mbi atë se çfarë po ndodhte në Kosovë. Policia serbe shkatërroi dhe plaçkiti objektin e Radio 21 dhe mua së bashku me kolegët e mi na depërtoi në Maqedoni. Pak ditë pas këtyre ngjarjeve, Shtetet e Bashkuara më ftuan që të dëshmoj për ngjarjet në Kosovë. Dëshminë time e dhashë para Senatit Amerikan por edhe në programe të ndryshme TV siç janë CNN, C-SPAN, dhe FOX.

Pas kthimit tim nga SHBA-të, unë mora hapa të mëtutjeshëm. Filluam të transmetonim nga Shkupi dhe të japim informata mbi atë që po ndodhte në Kosovë. Brenda pak ditëve transmetonim programe ditore për rreth dy orë e gjysmë, përmes Radio Hollanda në valë të shkurta. Kur trupat e NATO-s hynë në Kosovë me 15 korrik 1999, punëtorët e Radio 21 mblodhën pajisjet nga Shkupi, u kthyen në Prishtinë, instaluan pajisjet teknike dhe startuan me programin 24 orësh nga kryeqyteti i Kosovës. Ishte radiostacioni i parë në Kosovën e pasluftës.

Mezi prisnim të ktheheshim. Kur filluam me transmetim ishte një përjetim i papërshkrueshëm dhe stafi ynë, femra e meshkuj, po qanin nga gëzimi sepse kishin pritur kohë të gjatë për këtë moment. Në të njëjtin vit, unë mora ftesën të shkojë në SHBA për të pranuar shpërblimin për "Kurajë në Gazetari" nga IWMF.

Në Kosovë kishte nevojë të madhe për media. Unë luftova për të kthyer frekuencat kombëtare të radio televizionit në Kosovë. Kishte tendenca nga televizionet në Kosovë të transmetonin vetëm përmes satelitit, pasi që frekuencat kombëtare ishin bllokuar nga Beogradi. Rrjeti tokësor i transmetimit u themelua në Kosovë me ndihmën e USAID-it. Pasi që posedoja leje ndërkombëtare, fillova me programin televiziv në TV 21 në Shtator të vitit 2000. Në fillim kishim program vetëm për dy orë. Pas gjashtë muajsh, programi u zgjat në 6 orë, pas nëntë muajsh në 8 orë e gjysmë dhe në Shtator 2001 kishim 18 orë program në ditë. Në Shtator 2002, TV 21 transmetonte 24 orë program në ditë - në rrjetin tokësor dhe atë satelitor. Stacioni filloi transmetimin në Amerikën Veriore. Ishte televizioni i parë shqiptarë në Amerikë.



Por unë nuk do të ndalem me kaq. Unë dua që të emetojë program për shqiptarët të cilët jetojnë në Australi dhe Zelandë të Re. Transmetimet testuese kanë filluar të bëhen në këtë pjesë të botës, dhe qëllimet janë që veprimtarinë ta fillojmë në vitet në vijim.

### **Dhurata Bardoniqi – Menaxhere e “ARKING” Tejkalimi i pengesave në kohë të vështira**

Unë quhem Dhurata Bardoniqi dhe jam e lindur në Dibër, Maqedoni. Shkollën fillore dhe të mesme e kam kryer në qytetin tim të lindjes, e pastaj shkova në Universitetin e Prishtinës. Kur u martova jam shpërngulur në Gjakovë. Që nga vitit 1989 unë jam bashkëpronare dhe menaxhere e ndërmarrjes ARKING, e themeluar nga bashkëshorti im (i cili ishte arkitekt me profesion) dhe nga një ortak i tij. Ndërmarrja kryen veprimtari në sektorin e ndërtimtarisë. Para luftës ne kishim një spektër të gjerë klientësh në mbarë Kosovën dhe Shqipërinë. Në vitin 1999, kur filloi lufta, burri im u vra dhe ndërmarrjes së bashku me tërë pasurinë ia vunë zjarrin militarët serb.

Në ditët e para të pasluftës ne përjetonim një krizë emocionale dhe financiare e cila edhe na parandalonte që të vazhdojmë biznesin tonë. Por u desh që ne t'i bashkojmë forcat, sidomos ato emocionale, dhe me një organizim dhe kuadër të shkëlqyer (të njëjtin që punonte me ne edhe para luftës) të arrinim t'ia dalim mbanë. Ne punonim në pjesë të ndryshme të Kosovës dhe shfrytëzonim çdo mundësi që na paraqitej.

Firma jonë merret kryesisht me punë ndërtimore dhe infrastrukturë, si dhe dizajnim. Gjatë viteve të fundit, ne kemi punuar për Kryqin e Kuq Britanez në renovimin dhe ndërtimin e shkollave të reja. Gjithashtu, kemi punuar për trupat e KFOR-it italian në aeroportin e Gjakovës, për kryqin e Kuq Danez, si dhe për ACT Internacional. Kemi punuar edhe akoma punojmë për Agjencionin Evropian për Rindërtim (AER-in). Kontratat e punës me AER-in përfshijnë renovimin e qendrës studentore dhe renovimin e burgut të Dubravës. Përveç këtyre kontratave, ne kemi ndërtuar edhe shtëpi private dhe depo të ndryshme për ndërmarrje, bazuar në projektet dhe dizajnët tona.

Pas gjithë këtyre viteve të punës, viti më i suksesshëm për mua ishte viti 2004, kur edhe u emërova për “Menaxherja më e suksesshme e Vitit 2004” nga Rrjeti i Grave Afariste të Kosovës dhe nga Oda Ekonomike e Kosovës, ku edhe fitova shpërblimin si “Gruaja më e suksesshme menaxhere në afarizmin Kosovar”.

Përveç që drejtoj ndërmarrjen time, unë gjithashtu kaloj kohë të këndshme me dy fëmijët e mi Edonin (15 vjeç) dhe Rinën (8 vjeçe), të cilëve mundohem të iu sigurojë shkollimin më të mirë që është i mundshëm.

### **Ola Sylja – Menaxhere në “Drita e Krushës” “Drita e Krushës” ndihmon Krushën e Madhe**

Shoqata e gruas “Drita e Krushës” është bërë e njohur në tërë Kosovën si prodhues i vetëm i perimeve të konservuara (turshive). Rritja e kërkesës për këto produkte tregon se si janë pritur

këto produkte në treg. Ky sukses nuk është i rastësishëm, nëse kemi parasysh cilësinë e lartë të prodhimeve dhe udhëheqjen profesionale të punës.

Ola Sylja, udhëheqëse e kësaj shoqate të formuar menjëherë pas luftës, kishte përvojë në këtë lëmi. Që nga viti 1995, ajo ishte pjesë e një grupi të organizuar të grave që punonin me vajzat e reja në fushën e shëndetësisë, arsimit, etj. Krusha e Madhe është një ndër zonat më të goditura edhe me pasoja të mëdha nga lufta e vitit 1999. Kjo ishte edhe arsyeja kryesore që e shtyri Olen të vazhdonte veprimtarinë e saj në këtë rajon. Qëllimi kryesor ishte të ndihmohen 2004 gra të veja dhe 504 fëmijë bonjak. Në vitin 2002, kompania “Drita e Krushës” filloi me aplikimin e projekteve përfituese, duke përfshirë edhe konservimin e perimeve. Krusha e Madhe është e njohur me produktet e saj bujqësore, nga të cilat varen 90% të popullatës, mirëpo çmimet e prodhimeve bujqësore në periudhën e pas luftës kanë qenë shumë të ultë. Të pakënaqura me këto kushte dhe nën udhëheqjen e Olës, gratë e Krushës vendosën të konservojnë perimet dhe të shesin ato me çmime më të larta.

Duke arritur të shesin sasinë prej 1000kg brenda një jave, në vitin 2001 u dëshmuar se sa e suksesshme ishte kjo iniciativë e grave të Krushës së Madhe. Mënyra tradicionale “shtëpiake” e konservimit të perimeve pa pesticide, kontrollimi i përhershëm i kualitetit dhe cilësia e lartë e këtyre prodhimeve që ishin rezultat i një pune të përkushtuar të këtyre grave, dhe njëkohësisht një nga arsyet kryesore për kërkesë aq të madhe të prodhimeve të tyre në tregun Kosovar.

Treguesi më i rëndësishëm i suksesit të tyre ishte fakti se edhe pse në vitin 2002 trefishuan prodhimin, nuk arritën të përmbushin kërkesat e tregut. Gratë e Krushës arritën të dyfishojnë prodhimin në vitin 2003, duke përpunuar 6.000 kg perime dhe duke e zgjëruar prodhimin në 13 lloje të ndryshme të perimeve të konservuara. Sot në shoqatën “Drita e Krushës” punojnë 20 gra dhe realizojnë prodhim të njëjtë me atë të vitit të kaluar. Kjo shoqatë ka arritur suksese të mëdha duke, furnizuar një numër të madh konsumatorësh të rregullt, si dhe shumë restorante nëpër Kosovë.

### **Gjyle Idrizaj – Menaxhere Pronare e fermës së lopëve “H&H”**

Gjyle Idrizaj, pronare dhe menaxhere e fermës së lopëve “H&H” është afariste e suksesshme. Me punën e saj është bërë e famshme jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë kufijve të saj. Suksesi i sajë dëshmon se puna e palodhshme dhe vullneti mund t’i çojë gratë drejt suksesit edhe në lëmi deri tani të “rezervuara” për burrat.

Puna në fermë nuk ishte e panjohur për Gjylen, pasi që para se ta dëbonin nga puna në fillim të viteve 1990, kishte punuar për 11 vjet në fermën shtetërore në Miradi të Epërme si laborante / teknike e veterinarisë. Ndaj ishte e natyrshme që menjëherë pas luftës të kthehej në fermë. Gjyla e gjeti fermën në gjendje të papërshtueshme: kafshë të ngordhura, mbeturina në çdo anë dhe stallat e dëmtuara. Mirëpo, me entuziazmin i cili erdhi pas çlirimit dhe dëshira që të fillojë punën sa më parë, e ndihmuan Gjylën t’i tejkalojë vështirësitë. Me një traktorë dhe me punën e përbashkët të disa ish punëtorëve të fermës, ndër ta edhe bashkëshorti i Gjylës, dhe me përkrahjen e Qeverisë së Zvicrës ia arriti të ringjallë fermën. Ferma e tyre shërbeu si një stacion karantine për lopët e sjella nga Zvicra për të ndihmuar fermerët në Kosovë. Gjatë 18 muajve të parë, nga kjo fermë u shpërndanë 8.200 krerë lopë nëpër tërë Kosovën. Përveç kujdesit ndaj lopëve në fermë, Gjylja ishte e angazhuar edhe në vizitat

monitoruese tek fermerët që merrnin lopë, për të këshilluar dhe për të përcjell zhvillimin e tyre.

Kur Gjylës iu ofruan 36 lopë të mbetura nga programi i qeverisë së Zvicrës, ajo me ndihmën e bashkëshortit të saj, e përshtati një fermë të braktisur të derrave dhe krijoi fermën e saj private. Si shpërblim për punën e saj, qeveria e Zvicrës i dhuroi një traktorë, aparat për mjelje dhe një laktofriz. Për tetë muaj Gjylja arriti ta rrisë numrin e lopëve në 87 dhe të përpunoj 175 hektarë tokë për prodhim të ushqimit për kafshë dhe 40 hektar për prodhimin e grurit.

Sot Gjyla kujdeset për 120 krerë lopë në fermën e saj, punë kjo shumë komplekse dhe sistematike, me orar të përpiktë të ushqimit, të mjeljes dhe pushimit, me kujdes të veçantë në higjienë, një ndër faktorët më të rëndësishëm në shëndetin e lopëve dhe kualitetin e qumështit, i cili analizohet çdo 15 ditë. Gjyla vetë përkujdeset për shëndetin e lopëve dhe jo vetëm në fermën e saj. Gjyla inspekton lopët edhe në ferma të tjera dhe mban trajnime të ndryshme për bujqësi, trajnime që financohen nga donatorët që merren me zhvillimin e fermave. Përveç kësaj deri me sot femra e Gjylës ka shërbyer si shkollë për mësim praktik për 340 nxënës të shkollës së mesme të bujqësisë dhe 20 student të Fakultetit të Veterinarisë.

E tërë kjo nuk do të ishte e mundur pa punën e Gjylës, e cila e plotëson punën e bashkëshortit të saj në menaxhimin e bujqësisë. Suksesi i saj pati ndikim pozitiv në zhvillimin e bujqësisë në komunën e Shtimes, ku gjendet ferma e saj. Shumë fshatarë, të frymëzuar nga të arriturat e saj, ju kthyen bujqësisë dhe ajo sot bashkëpunon ngushtë me 42 fermerë. Gjyle Idrizaj është edhe kryetare e shoqatës së bujqve “Bioprodukt” në komunën e Lipjanit. Kjo shoqatë siguron tregun për 52 anëtarët e saj. Shoqata në të ardhmen planifikon të formojë edhe një kooperativë bujqësore që do të rriste bashkëpunimin në mes të bujqve dhe do të krijonte mundësi më të mëdha për përmirësimin e kushteve të prodhimit.

“Bujqësia kërkon përkrahje të madhe nga qeveria dhe zvogëlim të tatimeve, çmimit të rrymës, derivateve të naftës e në veçanti, kushte më të volitshme të kreditimit për ti stimuluar fshatarët t’i kthehen arave,” porositi Gjyla. Sa i përket pozitës së grave në bujqësi, Gjyla pohon me keqardhje se puna e vështirë dhe fitimi i ulët nuk i tërheqin gratë të merren më seriozisht me këtë lëmi. Porosia e saj është se gratë duhet të jenë këmbëngulëse e të vendosura, suksesi nuk do të mungojë dhe ky sukses do t’u mundësojë edhe të fitojnë pavarësinë ekonomike.

### **Luqije Deda – Menaxhere Pronare e biznesit të vogël “Sweet breeze”**

Luqija punonte në ndërmarrjen “Liria” në Prizren dhe pas dëbimit nga puna, siç ishte rasti me shumicën e shqiptarëve në Kosovë në vitet e 90-ta fillojë të kërkojë ndonjë punë tjetër për të mbijetuar dhe mbajtur familjen. Ishte shumë vështirë në atë kohë për tu punësuar, shprehet Luqija, dhe kështu fillova me mbarimin e ëmbëlsirave (torta dhe më së shumti dekore për torta). Fillova të mbarojë ëmbëlsira në shtëpi. Ëmbëlsirat dhe dekoret ishin të ndryshme nga ato që u ofronin klientëve në qytet ëmbëltoret, mirëpo edhe çmimi i ëmbëlsirave të Luqies ishte më i lartë. Në fillim ëmbëlsirat e saj bliheshin vetëm nga kushërinjtë dhe miqtë e saj, e më vonë filluan të kërkojnë edhe njerëz të tjerë për raste të ndryshme dhe ndonjë festë.

Mbas luftës 1999, Luqia kërkojë punë në profesion të sajë, pasi që ishte ekonomiste e diplomuar dhe kishte një përvojë shumë vjeçare si kontabiliste. Kështu ajo fillojë të punojë në një firmë private si kontabiliste.

Rastësisht, siç tregon Luqia, jam takuar me aktivisten e lëvizjes së grave Zj. Igballe Rogova, e cila i ka treguar se mundet të kërkojë mbështetje nga donatorët për të hapur punëtorin e saj dhe për të vazhduar me mbarimin e ëmbëlsirave aq shumë të kërkuara. Ëndrra e Luqies u realizua me ndihmën e cila iu ofrua nga UNHCR dhe IGK (Iniciativa e Grave Kosovare). IGK në vitin 2000 e mbështeti financiarisht tre muaj për të hapur punëtorin e saj, dhe për të punësuar edhe 8 gra të tjera. Tre muajt e parë rrogat e të punësuarve u siguruan nga kjo organizatë. Puna vazhdojë shumë mirë me menaxhimin e mirë të Luqies. Kërkesat e klientëve filluan të rriteshin çdo ditë, jo vetëm në Prishtinë por edhe në komunat tjera të Kosovës. Luqia nuk kishte kapacitet që të përmbushë kërkesat e tregut me ëmbëlsirat e saja shtëpiake, dhe nuk kishte mundësi që të zgjerojë biznesin e saj, sepse mendonte se është shumë herët për të ndërmarrë një hap tjetër. Mirëpo gratë e qyteteve të tjera vinin dhe kërkonin nga Luqia që të ju mbante kurse ku ato do të mësonin të mbaronin ëmbëlsira të njëjta dhe do të fillonin në qytetet e tyre.

Luqia fillojë të mësojë gratë e tjera duke i ndihmuar ato të fillojnë me të njëjtin afarizëm. Pas një kohe, ajo furnizonte jo vetëm klientët e saj të rregullt por edhe restorantet e shumta në Prishtinë, dhe ka lidhur një kontratë me Hiper Marketin “MAXI”.

Luqia shpreson se në të ardhmen do të krijohet një ambient më i përshtatshëm dhe kushte më të volitshme për zhvillimin e afarizmit në Kosovë, gjë që do t'i mundësonte edhe zgjerimin e afarizmit të saj.

### **Hyrmete Celina – Menaxhere Biznesi “SIBORA” – Prizren**

Hyrmete Celina, është nënë e tre fëmijëve dhe stiliste me profesion. Ajo e mbaroi shkollën në vitin 1983 në Maribor të Sllovenisë dhe filloi të punojë si stiliste në fabrikën e tekstit “Printex” në Prizren. Pas 16 viteve punë u largua nga fabrika për arsye të njohura të okupimit Serb.

Para luftës në vitin 1999, Hyrmetja ka menaxhuar biznesin e saj në Prizren, një atele të veshjeve të brendshme, ku iu mësoi zejen grave të cilat ishin të larguara nga puna. Disa nga gratë edhe u punësuan në afarizmin e saj. Pasi filloi lufta në Kosovë, Hyrmetja së bashku me familjen e saj shkuan në Stamboll në Turqi ku arriti të gjejë punë në një fabrikë të tekstit.

Pas mbarimit të luftës, së bashku me familjen u kthye në Kosovë dhe filloi me profesionin e saj duke ofruar kurse profesionale të rrobaqepësisë për gratë tjera, në mënyrë që njëkohësisht të rifillojë punën e saj dhe ti ndihmojë ato. Kurset u ofruan në gjashtë fshatra të komunës së Prizrenit. Në vitin 2000, Hyrmetja u punësua në OJQ-në Humanitarian Cargo Carriers (HCC) dhe ndihmoi gratë për të gjetur tregun për shitjen e punimeve të tyre, në vise të ndryshme rurale të Prizrenit.

Në Gushtë të vitit 2002, Hyrmetja mori iniciativën dhe ftoi një grup prej 15 grave të nacionaliteteve të ndryshme: turke, shqiptare, boshnjake dhe rome, dhe themeloi OJQ me emrin “SIBORA”. Me mbështetjen e donatorëve siç ishin: Iniciativa e Gruas Kosovare (KWI), Zhvillimi i bashkëpunimit me Zvicrën (SDC), ICMC, dhe me kursimet e saj bleu disa makina të qepjes dhe filloi të punojë në një punëtori të vogël me qëllim zgjerimi. Produktet

ishin të një kualiteti të mirë dhe tregu i kërkonte, mirëpo si çdo biznes tjetër, kishte edhe vështirësi.

Në vitin 2004, Hyrmetja me ftesë të Znj. Milrinda Kusarit kishte rastin të marrë pjesë në Panairin ndërkombëtar në Celje të Sllovenisë, ku një numër i kontakteve fillestare së shpejti u krijua në partneritet konkret. Prodhimet e saj atraktive nga pambuku, siç janë veshjet e brendshme arriti t'i shesë partnerëve Slloven dhe Hyrmetja mori ofertë për hapjen e dyqanit në qytetin Izola të Sllovenisë, si dhe plasman të sigurt në Slloveni.

“ Pjesëmarrja jonë në panairin ndërkombëtar kishte rëndësi të madhe. Pas dhjetë viteve izolimi, na u sigurova mundësia të shohim vetë se ç'farë janë kërkesat e tregut dhe cila është pozita e jonë në tregun Evropian. Arrita të bëjë marrëveshje me blerës potencial dhe të plasoj prodhimin tim jashtë Kosovës. Asgjë nuk mund të gjendet në depon tonë. Çdo gjë është shitur. Kjo më mundësoi të investojë në punëtorinë e re dhe të rris kapacitetin e prodhimit”.

### **Mire Komani – Menaxhere Biznesi i kultivimit të kërpudhave “ILIRI”**

Mira Komani jeton dhe punon në fshatin Guskë të komunës së Gjakovës, por është e lindur në Klinë, ku përfundoi shkollimin e saj dhe fitoi një thirrje në biologji-kimi. Para luftës punoi në fabrikën e kërpudhave të quajtur “Shapinjon” në Klinë. Gjatë luftës, si shumë gra të tjera e humbi bashkëshortin dhe si kryefamiljare është detyruar të mendojë se si ta sigurojë ekzistencën për vete dhe familjen time.

Fshati Guskë përveç dëmeve materiale, ka pas shumë humbje edhe në njerëz kryesisht meshkuj dhe pothuajse 90% e femrave kanë mbetur kryefamiljare dhe pa asnjë burim të vetëm që të sigurojnë ekzistencën për familjet e tyre.

Pasi eksperiencia e vetme që kishte Mira ishte kultivimi i kërpudhave, asaj i lindi ideja për ndërtimin e një fabrike të vogël për kultivimin dhe konservimin e kërpudhave e cila do të krijonte vende të reja të pune për gratë kryefamiljare të fshatit. OJQ Italiane Caritas Lombardia ofroi një ndihmë afatgjate duke investuar në një fabrikë të vogël për kultivimin e kërpudhave. Me disa iniciativa, inkurajim dhe përkrahjen e OJQ Italiane Caritas, afarizmin e filloi në vitin 2002. Caritasi sigurojë mjetet financiare për ndërtimin e objektit dhe instalimin e rrymës dhe pajisjeve për të kultivuar kërpudhat, kurse OJQ "Nëna Terezë" me seli në Lucern të Zvicrës dhe Caritasi Australian gjithashtu përkrahën dhe ndihmuan.

Përkundër kualitetit të mirë të kërpudhave, afarizmi kishte disa vështirësi si: plasimi i produkteve në treg, aftësitë e dobëta menaxhuese dhe të marketingut, etj. Në fabrikë, përveç mbjelljes dhe konservimit të kërpudhave ishte e nevojshme të sigurohet higjiena e lartë dhe kushtet klimatike. Përveç kësaj kishte edhe probleme tjera si plaçkitja dhe vjedhja e pajimeve.

Stafi i punësuar në “Shapinjon” ka ndjekur trajnime dhe këshillime të rregullta, sidomos lidhur me zhvillimin e planit të biznesit dhe pjesëmarrjes në panairë të ndryshme. Trajnimi dhe këshillimet kanë treguar se hulumtimi i tregut është esencial për funksionimin e një afarizmi.

“Pas një hulumtimi efektiv të tregut, kemi konstatuar se produktet tona janë mjaftë të kërkuara, mirëpo problemi qëndron në ambalazh. Tregu kërkon një ambalazh të mirëfilltë me të cilën ne nuk disponojmë edhe pse kapaciteti jonë prodhues është mjaft i lartë (5 ton kërpuha në 3 muaj, 20 ton për një vit). Ne ende vazhdojmë me afarizmin tonë, edhe pse kushtet momentale për zhvillimin e veprimtarisë afariste në Kosovë nuk janë të favorshme, në veçanti kushtet kreditore dhe siguria”, thotë Mira.

## **Kapitulli 17**

### **Konkludime**

Hulumtimi ka për qëllim që këto të dhëna të shërbejnë si instrument i marketingut me anë të së cilës promovohet gruaja ndërmarrëse në Kosovë. Rezultatet e hulumtimit prezantojnë mendimet personale të grave afariste në 30 komunat e Kosovës. Për më tepër, ky hulumtim do të shërbej si bazë fillestare e të dhënave, për gjendjen reale të bizneseve të cilat menaxhohen nga gratë.

Gratë afariste vlerësohen si pjesë e qëndrueshme për zhvillimin ekonomik të një vendi qoftë duke u marrë me prodhim apo tregti. Megjithatë, ndonëse pjesa dërmuese e grave afariste të Kosovës punojnë në sektorin jo formal të ekonomisë, kontributi i tyre shpeshherë nuk çmohet. Veprimtarit afariste të grave ekzistojnë dhe shumica e tyre shfrytëzojnë më pak teknologjinë moderne në krahasim me veprimtarit e ngjashme afariste të zhvilluara nga burrat, dhe janë të koncentruar në aktivitete tradicionale, si rrobaqepësi, floktare, përgatitje të ushqimit dhe artizanat. Nga përgjigjet në pyetjet e bëra dhe nga përshtypjet e përgjithshme të intervistave të stafit hulumtues, SHE-ERA del me këto konkludime:

- Nga 1450 gra të intervistuar, 35 përqind janë përgjigjur se zhvillojnë afarizëm jo formal. Nga kjo përqindje e bizneseve jo formale, 96 përqind e tyre janë deklaruar se legjislacioni nuk është pengesë për të zhvilluar veprimtarin afariste, pasi që nuk e kanë të regjistruar veprimtarin afariste. Kjo është konstatuar nga pyetjet në pyetësor, ku nga gratë nuk janë siguruar informatat lidhur me emrin e veprimtarisë afariste sepse nuk e kanë regjistruar atë.
- Pjesa më e madhe e grave në biznes janë prezentë në sektorin e tregtisë (ushqimore, tekstil, kozmetik, librari dhe mallra të përzier), në sektorin e shërbimeve (floktari, sallon bukurie, shërbime shëndetësore, kompani të sigurimeve, kopshte të fëmijëve, agjension turistik, internet kafe dhe auto-shkolla). Një numër i vogël i tyre merren me prodhim/përpunim të produkteve (tekstil – rrobaqepësi, punë dore, prodhime të qumështit, furra të bukës, përpunim të perimeve), si dhe në sektorin e bujqësisë (bletari, blegtori dhe agrikulturë).

- 56.30 përqind zhvillojnë afarizmin e tyre vetëm, meqenëse është fjala për veprimtari të vogla afariste dhe nuk kanë mundësi të punësojnë dikë tjetër. Më shumë se 40.30 përqind zhvillojnë biznesin e tyre me më pak se pesë punëtor.
- 83.9 përqind të grave afariste janë aktive në bizneset e tyre me më pak se 10 vite (12.10 përqind 0 - 1 vjet; 24.5 përqind 1 – 2 vjet; 33.30 përqind 2-5 vjet; 14 përqind 5-10 vjet), ndërsa 16.10 përqind përmbi 10 vjet. Kjo tregon se shumica e veprimtarive afariste janë shumë të reja, dhe janë krijuar pas periudhës së luftës si nevojë për të mbijetuar dhe për tu pavarësuar.
- Shumica (97 përqind) e produkteve dhe shërbimeve që gratë i ofrojnë plasohen në tregun lokal dhe vetëm 3 përqind në tregun e huaj.
- 77.4 përqind e grave kanë deklaruar se i përkushtohen afarizmit të tyre mbi 8 orë në ditë, ndonëse kanë obligime familjare shtesë në shtëpitë e tyre.
- Sipas konkludimeve të drejtuesve të anketave, gratë ndërmarrëse në Kosovë kanë mungesë të përgatitjes dhe gatishmërisë profesionale për të menaxhuar me sukses një afarizëm. Kjo dëshmohet qartë nga përgjigjet në pyetjet lidhur me rregullativën ligjore ekonomike ku gratë nuk janë të njohin ligjet ekzistuese të cilat mund të mbrojnë interesat e afarizmit të tyre. Përveç kësaj, gratë janë përgjigjur se këshillohen me persona të cilët nuk janë profesionist për të ofruar këshillat e nevojshme për të menaxhuar dhe zhvilluar një afarizëm. Kjo dëshmohet nga vetë fakti ku 45 përqind e tyre këshillohen me bashkëshortin.
- Një nga problemet më të mëdha për hapjen dhe zhvillimin e veprimtarive afariste të grave, janë kushtet kreditore jo stimuluese. 20 përqind e grave janë deklaruar se kanë mjaftë vështirësi për të siguruar kredi nga bankat ekzistuese në Kosovë, si pasojë e interesit të lartë dhe kohës së shkurtër për kthimin e kredisë. Përveç tjerash, bankat nuk japin kredi për fillimin e biznesit, duke iu siguruar kështu ndihmë financiare vetëm veprimtarive ekzistuese afariste. Ato gjithashtu kanë përmendur se u është kërkuar nga to hipoteka (pasuri) të cilën ato nuk e posedojnë, pasi në shumicën e rasteve pasuria në Kosovë është e regjistruar në emër të burrit, babait, vëllait, dhe vetëm në disa raste të veçanta (gratë kryefamiljare) posedojnë me pasuri të patundshme në emër të tyre.
- 32 përqind e të anketuarave janë deklaruar se nuk kanë ndjekur asnjë trajnim për zhvillimin e kapaciteteve të tyre menaxhuese, ndërsa 68 përqind e tyre janë deklaruar se kanë ndjekur trajnime të ndryshme. Sipas komenteve të tyre, sesionet e ndjekura të trajnimit kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kapaciteteve të tyre dhe aplikimin e njohurive të reja në veprimtarin e tyre afariste.
- Më tepër se gjysma e grave të anketuara, 54 përqind, janë deklaruar se do të vazhdonin me afarizmin ekzistues, përderisa 28 përqind e tyre janë deklaruar se nëse ju ofrohet mundësia për të filluar një punë tjetër do ta mbyllnin afarizmin ekzistues. 18 përqind nuk janë shumë të kënaqura me të hyrat e nga afarizmi i tyre, mirëpo nuk mendojnë se do të kalojnë në ndonjë afarizëm tjetër.
- 82 përqind e tyre janë deklaruar se kanë nevojë për aftësi profesionale të ndryshme, dhe 9 përqind janë deklaruar se kanë nevojë për trajnime, specifike të cilat lidhen

direkt me veprimtarin e tyre afariste. 9 përçind janë deklaruar se nuk kanë nevojë për trajnime.

## **Kapitulli 18**

### **Rekomandime**

Për kundër përqendrimit të shumë organizatave ndërkombëtare dhe vendore përpjekjeve të SPVQ për fuqizimin e ekonomisë në Kosovë, shumë pak është bërë në gjashtë vitet e fundit. Një vështrim i përgjithshëm i hulumtimit për këtë publikim tregon se shumë më tepër duhet bërë për sa i përket krijimit të kushteve të favorshme ekonomike për zhvillimin e biznesit dhe promovimin e një klime të ndërmarrësis në Kosovë, sidomos në lidhje me përkrahjen e iniciativave të grave afariste.

Me kompletimin e këtij studimi të 1450 intervistave të grave afariste nga 30 komuna të Kosovës, kemi dalë me disa analiza dhe rekomandime. Propozimet në vijim dalin drejtë për së drejti nga Plani për Veprim i Pekinit dhe treguesit ekonomik të paraparë në Planin për Veprim të Kosovës për Arritjen e Barazisë Gjinore, në Standardet për Kosovën dhe në Prioritetet për Partneritet Evropian.

1. Qeveria e Kosovës, veçanërisht Ministria për Ekonomi dhe Financa (MEF), Ministria për Tregti dhe Industri (MTI), dhe UNMIK-u shtylla e IV për Rindërtim Ekonomik (Bashkimi Evropian), në bashkëpunim me institucionet financiare bankare duhet të: ndërmarrin masa pozitive, duke përfshirë strategjitë ekonomike të vetëpunësimit të grave, dhe inicimin, zhvillimin dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së afarizmit të grave.
2. Qeveria e Kosovës duhet të ndajë një pjesë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës në mënyrë që t'iu ofrojë hua grave përmes partneritet me institucionet ndërmjetësuese financiare për t'i administruar këto hua, dhe përmes programeve që ofrojnë kushte të veçanta kreditore për gratë.
3. Qeveria duhet të promovojë dhe të fuqizojë ndërmarrjet e vogla, veprimtarit e reja afariste, mundësit ndërmarrëse, dhe atje ku është e mundur, të ndihmojnë tranzicionin me krijimin e ambientit të volitshëm për zhvillim ekonomik, nga afarizmi jo formal në afarizmin formal.
4. Qeveria duhet të rishikojë, dhe nëse është e nevojshme, të reformojë politikat, duke përfshirë ligjet e qeverisë dhe rregulloret mbi veprimtarit afariste, tregun, dhe kontratat, për të siguruar se ato nuk janë diskriminuese ndaj grave.
5. Të fuqizohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të sektorit publik dhe privat me qëllim të përfshirjes së grave në veprimtarit afariste dhe fuqizimin e tyre ekonomik, përmes krijimit të inkubatorëve të biznesit për gra në komuna dhe në veçanti inkubatorit të artizanaleve.



6. Të krijohen programe të reja dhe fleksibile me institucionet ndërmjetësuese, të cilat kanë si synim zhvillimin ekonomik të grave, dhe të cilat promovojnë partneritetin ndërmjet qeverisë, institucioneve financiare, dhe grave afariste.
7. Institucionet profesionale, OJQ vendore dhe ndërkombëtare, duhet të dizajnojnë dhe zbatojnë programe të cilat sjellin në jetë aktivitetet ndërmarrëse dhe të qëndrueshme të grave. Programet e këtilla duhet të sigurojnë trajnime të cilat i rritin aftësitë, veçanërisht sa i përket teknologjisë moderne, metodologjisë afariste, dhe shërbimeve afariste për gratë në menaxhimin e afarizmit, zhvillimin e produkteve, financave, prodhimin dhe kontrollin e kualitetit, në marketing dhe në aspektet ligjore të afarizmit.
8. Të zhvillohet një pako e politikave dhe programeve të cilat do të siguronin qasje në trajnime dhe arsimim afatgjatë, i cili do të ishte në dobi të grave në bazë të nivelit të ndryshëm të tyre dhe strukturës së familjes.
9. Të ndihmohet vetëpunësimi me instruktorë të afta ndërmarrëse të cilët kanë për qëllim arsimimin e grave, skemave kreditore, ngritjen e vetëdijes lidhur me çështjet gjinore në banka dhe organizata, duke përkrahur kështu krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).

### **Akronimet dhe shkurtesat**

**SHE-ERA** – Shoqata e grave afariste

**OGA** – Zyra për Çështje Gjinore

**KBWN** – Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

**SME** – Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

**CEDAW** – Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

**ICMC** – Komisioni ndërkombëtar katolik për migrim

**FINCA** – Institucioni për mikro financa

**OEK** – Oda ekonomike e Kosovës

**USAID** – Agjensioni i shteteve të bashkuara për zhvillim ndërkombëtar

**MTI** – Ministria e tregtisë dhe industrisë

**KWI** – Iniciativa e grave të Kosovës